

URDHËR
Nr.209, datë 5.9.2011

PËR RILICENCIMIN E AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV PËR TË DREJTAT E ARTISTËVE INTERPRETË DHE/OSE EKZEKUTUES TË VEPRAVE, ME TË GJITHA FORMAT E PËRCJELLJES SË INTERPRETIM/EKZEKUTIMIT TË TYRE NË PUBLIK

Duke marrë parasysh propozimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit, nr.886, prot., datë 15.8.2011 për rilicencimin e agjencisë “AKDIE” për të ushtruar dhe mbrojtur të drejtat e artistëve interpretë dhe/ose ekzekutues të veprave, me të gjitha format e përcjelljes së interpretim/ekzekutimit të tyre në publik,

KONSTATOVA:

Se, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga ligji nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhur me të”, i ndryshuar, është kompetencë e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve miratimi i rridhënies së licencës kësaj agjencie në fushën e menaxhimit kolektiv të të drejtave të artistëve interpretë dhe/ose ekzekutues të veprave, me të gjitha format e përcjelljes së interpretim/ekzekutimit të tyre në publik, AKDIE.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të neneve 108, pika 1 dhe 109, pika 2 dhe 3, të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Rilicencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv për të Drejtat e Artistëve Interpretë dhe/ose Ekzekutues të Veprave, me të gjitha format e përcjelljes së interpretim/ekzekutimit të tyre në publik, AKDIE.

2. Afati i licencës është 3 (tre) vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS
RINISË DHE SPORTEVE
Aldo Bumçi**